



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 579/3 /prot

Gramsh, më 31/01 /2018

VENDIM

Nr. 08 datë 26/01 /2018

PËR DHËNIEN E TITULLIT VENDOR “QYTETAR NDERI” GRAMSHIT(PAS VDEKJES),KËNGËTARIT DHE INSTRUMENTISTIT **BASHKIM BENI**.

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9 germa a, neni 54 pika m; në Ligjin nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” neni 14, neni 15 pika 1/a dhe pika 2/b; në VKM Nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionin e komisioneve këshillimore për dhënie e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”; Rregulloren e Brendshme të Proçedurave për Dhënie e “Titujve Vendor të Nderit” neni 1/a, neni 3, neni 4, neni 5 dhe neni 7, Këshilli Bashkisë i mbledhur sot më datë 26/01 /2018, pasi mori në shqyrtim P/Vendimin dhe Relacionin e përgatitur nga Kryetari Bashkisë ;

VENDOSI:

1-Me rastin e 1-vjetorit të ndarjes nga jeta, të këngëtarit dhe instrumentistit **Bashkim Beni**, i datëlindjes 25/08/1958, t i jepet titulli vendor “**Qytetar nderi**” Gramshit, (pas vdekjes), me këtë motivacion:

“Aktivist i këngës, valles dhe instrumentave muzikorë në skenën e koncerteve të Pallatit të Kulturës, i festivaleve Folklorike Kombëtare në Gjirokastër, si dhe në qytete brenda dhe jashtë kufijve të vendit tonë.

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Agjensia e Mirqënies dhe Kujdesit Social-Kulturor.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Astrit DUZHA

KËSHILLI BASHKISË



ZV/KRYETARI
Edmond GURI

Konc. dok. A. Duzha
Pranoi: E. Guri
Kërkuesi: E. Guri
Drejtor
A. J. J.